



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN KRYESISHT TË ANËTARIT TË KZAZ NR. 27, ANËTARIT TË KZAZ NR. 67,
SEKRETARIT TË KZAZ NR. 84, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30
QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 13.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për lirimimin dhe emërimin kryesisht të anëtarit të KZAZ nr. 27, anëtarit të KZAZ nr. 67, sekretarit të KZAZ nr. 84, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 29, pika 5, neni 32, pika 1 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin dhe propozimet e paraqitura nga partia politike,

V Ë R E N

Me shkresën nr.2847 prot., datë 09.05.2019, anëtarja e KZAZ nr.27 zj.Erida Hoxha, e emëruar kryesisht me vendimin Nr. 141, datë 09.04.2019 të KQZ, për arsye objektive ka paraqitur dorëheqjen nga detyra e anëtares.

Me shkresën nr.2919 prot., datë 11.05.2019, anëtari i KZAZ nr.67 z.Florenc Hamolli, i emëruar kryesisht me vendimin Nr. 141, datë 09.04.2019 të KQZ, për arsye objektive ka paraqitur dorëheqjen, nga detyra e anëtarit.

Me shkresën nr.2870 prot., datë 10.05.2019, sekretari i KZAZ nr.84 z.Everaldo Hoxhaj, i emëruar kryesisht me vendimin Nr. 141, datë 09.04.2019 të KQZ, për arsye objektive ka paraqitur dorëheqjen, nga detyra si sekretar.



Nr. 302 i Vendimit Data 13.05.2019 e Vendimit Ora 13:00 e Vendimit

Për shkarkimin dhe emërimin kryesisht të anëtarit të KZAZ nr. 27, anëtarit të KZAZ nr. 67, sekretarit të KZAZ nr. 84, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

KQZ bazuar në në nenin 32, pika 1, gërma "c", të Kodit Zgjedhor, liron nga detyra dy anëtarët dhe sekretarin e emëruar kryesisht. Plotësimi i tre vakancave të krijuara do të bëhet duke përzgjedhur nga lista e shtetasve të miratuar nga KQZ me vendimin nr. 140, datë 09.04.2019, sipas procedurës së përcaktuar në Udhëzimin nr. 04 datë 19.02.2013, të ndryshuar me Vendimin nr.127, datë 04.04.2019.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 29, pika 5, nenin 32, pika 1 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

1. Të lirojë nga detyra anëtarin e emëruar kryesisht të KZAZ-së nr.27, KZAZ-së nr.67 dhe sekretarin e emëruar kryesisht të KZAZ-së nr.84, sipas lidhjes nr.1.
2. Të emërojë kryesisht anëtarin e KZAZ-së nr.27, anëtarin e KZAZ-së nr.67 dhe sekretarin e KZAZ-së nr.84, sipas lidhjes nr.2.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 302 i Vendimit Data 13.05.2019 e Vendimit Ora 13:00 e Vendimit

Për shkarkimin dhe emërimin kryesisht të anëtarit të KZAZ nr. 27, anëtarit të KZAZ nr. 67, sekretarit të KZAZ nr. 84, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.